

FJALA E DEPUTETES FLUTURA AÇKA

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

Doja vetëm t'i bëja një korigjim të vogël zëvendëskryeministrit në lidhje me Ballkanin e Hapur; është në të mirën e tij t'ia bëjë këtë korigjim. Këtu tha: "Kemi bekimin e Europës dhe Amerikës për "Open Balkan". Nuk e di nëse zoti zëvendëskryeministër e ndoqi zotin Escobar, i cili e tha shumë qartë që ka dy kushte. E para, që të jenë të gjashta vendet, të ketë mirëkuptim ky "Open Balkan"; e dyta, të jetë ekskluzivisht marrëveshje ekonomike.

Çfarë tha zëvendëskryeministri këtu? Tha se është marrëveshje ekonomike dhe politike. Kështu që bën mirë ta kafshojë gjuhën herë tjetër, kur është fjala për marrëveshje politike, sepse këto janë kafshatë e madhe për ne, Shqipërinë e vogël. Kjo nuk është marrëveshje politike, sepse nuk ka marrëveshje politike pa Kosovën. Kaq kisha. Faleminderit!